

LIGJ
Nr. 21/2017

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROJEKTIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA, SI AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “LINJA UNAZORE 110 KILOVOLT E SHQIPËRISË SË JUGUT”,
NËPËRMJET NJË HUAJE PREJ 500 000 EUROSH, TË RATIFIKUAR
ME LIGJIN NR. 10 251, DATË 11.3.2010**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 500 000 (pesëqind mijë) eurosh, të ratifikuar me ligjin nr. 10 251, datë 11.3.2010, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.3.2017

Shpallur me dekreten nr. 10075, datë 13.3.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KfW Bankengruppe, Postfach 111141, 60046 Frankfurt am Main

Operatori i Sistemit të Transmetimit
Drejtuar: Engjëll Zeqo, Administrator
Tiranë, Shqipëri

Ministria e Financave
Drejtuar Ministrit
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:
Ministrit të Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë
Drejtuar: Ministrit
Tiranë, Shqipëri

Bashkëpunimi Financiar i Qeverisë Gjermane me Qeverinë
Shqiptare për Zgjatjen e Afatit të disbursimit për linjën unazore
110 kV të Shqipërisë së Jugut

Marrëveshje Projekti dhe huaje:
Data: 4 janar 2010
Shuma: 500,000.00 euro
BMZ-nr. 2006 65 505
Nr. i huas 8243598

Datë: 20 shtator 2016

KfW Development Bank

Peter Ley
Ref. jonë: PeLe
Tel: +4969 7431- 3412
Faks: +4969 7431-3490
Peter.Ley@Kfw.de

Marrëveshja

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes së lartpërmendur dhe kërkesës suaj të datës 6 shtator 2016, për një zgjatje të afatit të disbursimit. Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se mund të përmbushim kërkesën tuaj.

Me qëllim zbatimin e aktiviteteve të fundit të projektit, siç është ndërtimi i N/stacioneve 110-kV Orikum dhe Himarë, jemi dakord me ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes:

Seksioni A- Ndryshimi i Marrëveshjes:

Marrëveshja (BMZ-nr. 2006 65 505) do të ndryshohet si më poshtë:

Neni 3.2: Afati për të kërkuar disbursim do të hiqet dhe do të zëvendësohet si më poshtë:

“KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 30 qershor 2018. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja mund të zgjasë afatin duke njoftuar Huamarrësin, sipas gjykimit të saj.”

Neni 7.3: Adresat e palëve kontratuale. Adresa e Huamarrësit ndryshohet si më poshtë:

“Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Kombit”, nr. 3

Bulevardi “Dëshmorët e

Tiranë
Shqipëri
Tel: +355 4 2228405
Fax: +355 4 2228494”

Seksioni B – Dispozita të tjera:

1. Kjo letër nuk e ndryshon ose heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje kredie

(huaje), përveç siç është përcaktuar shprehimisht në këtë letër.

2. Dispozitat e nenit 6 (Kostot dhe tarifat publike), nenit 7 (Vlefshmëria e kësaj marrëveshje huaje dhe projekti si dhe përfaqësimi) dhe nenit 9 (Dispozitat përfundimtare) të Marrëveshjes, do të përfshihen në këtë letër, siç janë përcaktuar në mënyrë të plotë në të dhe siç referencat në këto dispozita të Marrëveshjes janë referenca në këtë letër.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin dhe dispozitat shtesë të përcaktuara më sipër, duke nënshkruar në një formë ligjërish të detyrueshme dhe duke na kthyer një kopje sa më shpejt të jetë e mundur.

Me respekt,

KfW
Jürgen Kern
Drejtues Divizioni

Peter Ley
Menaxher Projekti

Lexuar dhe nënshkruar:

Tiranë 2016

.....

Për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Emri:

Titulli: